



GJYKATA E LARTË
DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN (MEDIAN) DHE ME JASHTË

Tiranë, 04.03.2022

NJOFTIM PËR MEDIAN

Lista e kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese

Zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 125 pika 1 të Kushtetutës si dhe nenin 7/ç të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, në datë 31.01.2022 ka bërë shpalljen publike për plotësimin e vakancës së pjesëshme në Gjykatën Kushtetuese, si rezultat i mbarimit të mandatit të znj. Vitore Tusha.

Pas përfundimit të afatit 30 ditor të pranimit të kërkesave, kandidatët që kanë paraqitur interes për plotësimin e vakancës janë:

1. Brunilda Kadi
2. Elsa Miha
3. Holta Zaçaj
4. Juliana Latifi
5. Sandër Beci

Bazuar në nenin 7/ç, pika 1 të ligjit Nr. 8577/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", të ndryshuar, lista e kandidatëve, si dhe dokumentacioni i paraqitur prej tyre i janë dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për vlerësimin e kushteve dhe kritereve të emërimit të gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese.

Për kontakt: Ida Vodica Laska
Drejtör i Marrëdhënieve me Publikun (Median) dhe me Jashtë
Email: ida.vodica@gjykataelarte.gov.al
www.gjykataelarte.gov.al

Te gjitha te drejtat e rezervuara. © 2010 Gjykata e Larte